


Teksti dhe vizatimet nga: Willem de Vink

# JEZUSI ËSHTË MESIA

Historia më e treguar e të gjithë kohërave






## CILI ËSHTË KUPTIMI



**BEKIMI:** Kjo është gjithë e mira që Zoti do t'ju japë njerëzve që bëjnë atë që Ai (faqe 10-11).

**BESIMI:** Të besosh që Zoti do të bëjë atë që ka premtuar (faqe 58).




**BIBLA:** Në Bibël lexon se çfarë menclon Zoti për njerëzit dhe si sillet Ai rreth ta.

**BIRI I ZOTIT:** Emri i Jezusit. Ai ishte Zot që erdhi dhe jetoi mbi tokë si njeri, si Biri i Zotit.



**DISHEPULLI:** Nxënës i Jezusit (faqe 18).

**ENGJEJT:** Lajmëtarët e padukshëm të Zotit (faqe 5).



**FALJA:** Zoti fal, megjithëse asnjë nuk e ka merituar vetë faljen. Zoti fal kur dikujt me të vërtetë i vjen keq për atë që ka bërë dhe dëshiron të ndryshojë. Kjo është bërë e mundur sepse Jezusi vulinetarisht mbarti ndëshkimin tonë mbi vete (faqe 58).



**FRYMA E SHENJTE:** Fryma e Zotit, me anë të të Cilit Ai do të jetojë brenda njerëzve që ndjekin rrugën e Jezusit (faqe 58).



**JETA E PERJETSHME:** Jeta me Jezusin, ashtu si e ka dashur Zoti. Kjo fiton mbi vdekjen dhe nuk ka fund (faqe 23, 29-30 dhe 59).

**JEZUSI:** Emri i Birit të Zotit, që do të thotë "Zoti shpëton".

**KRYQI:** Mjet torture në të cilën Jezusi dha jetën e Tij vullnetarisht. Kjo është bërë shenja të gjithë njerëzve që ndjekin udhën e Jezusit (faqe 25, 50).

**LUTJA:** Të flasësh me Zotin, pa zë ose me zë të lartë dhe të dëgjosh ato që të thotë Ai (faqe 18, 19, 42).

**MBREMJA E FUNDIT:** Nxënësit e Jezusit festojnë me bukë dhe verë vdekjen dhe ringjalljen e Tij (faqe 41)

**MBRETERIA E ZOTIT:** Kudo ku njerëzit i loinden Zotit gjende-t Mbretëria e Zotit.

**MEKATI:** Gjërat që bëjmë ne që janë kundra Zotit, duke humbur kështu qëllimin se përse na ka krijuar Zoti ne (faqe 4).

**MESIA:** "Mbreti i Përvajuar". Mesia (një fjalë në gjuhën hebreje) do të thotë në gjuhën greke "Krisht" (faqe 52, 55).

**PASHKET:** Festa në të cilën festohet ringjallja e Zotit Jezus. Në të njëjtët ditë Hebrenjtë festojnë festën Pascha (faqe 38-54).

**RIKTHIMI:** Kur Jezusi të kthehet përsëri mbi tokë, asgjë nuk do të mbetet ashtu si ishte. Qielli dhe toka do të ribëhen nga Zoti (faqe 57).

**RINGJALLJA:** Jezusi është ringjallur nga vdekja. Do të vijë një kohë kur të gjithë do të ringjallen nga vdekja. Dhe atëherë Zoti do të bëjë drejtësi për secilin (faqe 53- 57).

**SATANI:** Kundërshtari i padukshëm i Zotit dhe i njerëzve (quhet edhe ndjalli).





## KOHA E JEZUSIT

Numërimi i viteve tona fillon me lindjen e Jezusit. Në ato kohëra njerëzit udhëtonin në këmbë ose me gomerë, kamele ose kuaj. Në Hollandë dhe në Belgjikë banonin Batavianët, Frizët dhe Kaninefatët. Ata nuk mund të shkruanin ose të lexonin. Kishte disa popuj të tjerë që mund të shkruanin dhe të lexonin.

Një prej këtyre popujve ishte populli hebre në Izrael. Ata edhe quhen "Populli i Librit". Në atë libër, në Bibël, flet Zoti. Ai është Krijuesi i gjithçkaje që ekziston.

Dhe Ai do të ketë shoqëri me të gjithë njerëzit. Kjo e bën Jezusin të jetë i qartë në qëllimin e Tij.

## KUSH ËSHTË JEZUS MESIA?

Jezusi ka jetuar rreth 2000 vite më parë në Izrael. Ne e quajmë Atë Jezus Mesia ose Jezus Krisht. Kjo do të thotë që Ai është Mbret. Por Ai nuk është një mbret i zakonshëm. Jezusi quhet "Biri i Zotit", si edhe "Biri i Njeriut". Kjo do të thotë që Ai i përket edhe Zotit edhe njerëzve. Historia e jetës së Jezusit është përshkruar në Bibël. Kjo është historia më e treguar e të gjithë kohërave.







## IZRAELI NE KOHEN E JEZUSIT

Kryeqyteti: Jeruzalemi.

Provincat: Galilea, Samaria, Judea.

Sipërfaqia: Rreth 28.000 km katror (Hollanda ka sipërfaqe prej 36.758 km katror, Belgjika 30.514 km katror).

Klima: Subtropikale. Me vera të ngrohta dhe të buta dhe dim-ra të lagësht.

Politika: Që prej vitit 63 para krishtit Romakët kanë fuqinë në dorë në Izrael.

Qeverisja: Guvernatori romak, Pontius Pilati qeveris në Izrael Tiberiusi është superior i tij. Ai është perandori i Mbretërisë Romake.

Besimi: Hebreizmi. Ata kanë një tëmpull në Jeruzalem, priftë-rinj që bëjnë lloje të ndryshme punësh për besimin dhe mësuesit e fesë (si për Shembull farizenjtë) që u japin njerëzve mësim nga Bibla.

Gjuhët: Hebreishtja (gjuha e hebrenjve), greqishtja (gjuha ndërkombëtare), latinishtja (gjuha e romakëve).





Përse ëndërrojnë këta njerëz pranë lumit?



Bëju gati, sepse mbretëria e Zotit po vjen!





Fillo një jetë të re!



Sëpata e gjykimit të Zotit është gati, pranë rrënjëve të pemëve...



Çdo pemë që nuk jep fryte të mbara, pritet dhe hidhet në zjarr!




Atëherë ne duhet të shfarosemi të gjithë, sepse, kush është në gjendje të jetojë një jetë të ndryshme?

Pikërisht! Asnjëri nuk mund t'i shpëtojë gjykimit të Zotit. Por pas meje do të vijë dikush, i cili mund të të ndryshojë ty rrënjësisht.



Prano që nuk je njeri i denjë! a dëshiron që, që këtej e tutje, të jetosh një jetë tjetër? Pagëzohu atëherë në ujë.



Kështu e tregon te dëshirën për të filluar një jetë tjetër..




Predikanti pranë lumit quhet Gjon pagëzori...

Nuk behet fjalë për mua. Unë pregatis vetëm ardhjen e dikujt, i cili do të tregojë, se kush është Zoti. Ai do t'Ju pagëzojë në shpirtin dhe zjarrin e Zotit, gjë që të ndryshon rrënjësisht!



Dhë...




Unë... Unë duhet të pagezohem prej teje!



Ne duhet të veprojmë kështu, sepse vetëm në këtë mënyrë, ne plotësojmë dëshirën e Zotit.



O at, ardhë mbretëria jote dhe dëshira jote u plotësoftë!





Pastaj dëgjohej na ze nga qielli...

Po! Ti je biri im, të cilin e dua aq shumë!  
Ti je njeriu i zemrës time!





Është fillimi i numërimit tonë vjetor kur Gjon pagëzori përgatit në Izrael ardhjen e mesisë. Në atë kohë Izraeli ishte një pjesë e parëndësishme e pasurisë së madhe Romake.



Populli çifut në Izrael e ndjen veten të pafuqishëm dhe të shtypur. Ata mezi po presin mesinë, ai është shpëtimtari, që përmendet në librat e vjetër çifutë. Mesia do të bëjë, që fjala e Zotit të triumfojë.


Pranë lumit Jordan Gjoni tregon nga Jezus!

Vështroni! Ky është qengji i Zotit, që merr mbi vete gjithë mëkatet e botës!



Pas pagëzimit, shpirti i Zotit e udhëheq Jezusin për në shkretëtirë...

Al qëndron për 40 ditë dhe netë në këtë vend pa jetë. Gjatë gjithë kësaj kohe, ai nuk ha gjë. Duke u lutur dhe me patundshmëri forcon al besimin në detyren që e pret.



Jezusi do të luftojë me Satanin, të fuqishmin e padukshëm të errësirës, i cili i sjell botës vdekjen dhe shkatërrimin.



Për të fituar, Jezusi duhet të bëjë të qartë qëllimin e Zotit në bote. Plani i Zotit është, që njërezit të shpëtohen nga kthetrat e vdekjes.



Po o at! unë dua të bej atë, që dëshiron ti!



Por kundërshtari i pëshpërit Jezusit në mendimet e tij, për ta larguar atë nga detyra, që i ka dhënë Zoti.

*Në qoftë së ti je biri i Zotit, atëherë ktheji këta gurë në bukë!*

Jo! Sepse në libra është shkruar: Jo vetëm prej bukës jeton njeriu, por së pari, prej çdo fjalë, që flet Zoti.



*Në qoftë së ti je biri i Zotit, atëherë hidhu nga kjo majë e larte shkëmbi. A nuk është shkruar, që engjëjt do të të presin ty në krahët e tyre?*

*Vështro! Unë do të të jap ty të gjitha fuqitë mbi tokë, në qoftë së ti me përulesh dhe lutesh mua!*

Atëherë Satani e le Jezusin përkohësisht të qetë. Engjëjt vijnë t'I shërbejnë Jezusit...



Jo! është shkruar gjithashtu, që ti nuk duhet ta provokosh Zotin!



Largohu Satan! është shkruar që: Ti duhet ti lutesh dhe shërbesh vetëm Zotit tënd!




Kur kthehet për në Galile, Jezusi është i mbushur me shpirtin e shenjtë. Në këtë vend shumë të populluar, në veri të Izraelit u rrit Jezusi. Gjatë udhëtimit, shumë njerëz u afruan pranë tij. Ata janë kureshtarë të dinë, nëse Jezusi është Mesia i vërtetë, për të cilin kishin shkruar profetët...





Në Kana, diku në kodrat pranë Galileut, po festohet një dasmë.



Edhe Jezusi ka ardhur në këtë festë, së bashku me nënë dhe disa shokë të tij.









Kafarnaumi është një fshat ku jetojnë shumë peshkatarë, pranë liqenit të Galileut. Ketu, Jezusi fillon t'U flasë njerëzve për mbrëterinë e Zotit.



Këtu zgjedh ai nxënësit e tij të parë.



Pjetër, hajde të shkojmë në ujra të thella. Atje hidhi rrjetat e tua.



Mësues, në kemi qëndruar gjithë natën atje, pa peshkuar dot gjë.



Por, meqë ju thoni kështu...



Jo! E pabesueshme!







Jakobi Gjon!  
Ejani!  
Peshkimi i  
jetës tonë!



Largohu prej meje, o zot. Unë  
jam një njeri plot mëkate.

Mos u frikëso Pjetër. Që këtë e  
tutje, ti do të peshkosh njerëz.



Më ndiqn  
mua!

Ejani! prej jush unë do të  
bëj peshkatarë njerëzish!



Jezusi udhëton bashkë me nxënësit e tij neper gjithë Galilenë. Ai shpall ngado mbretërinë e Zotit. Ai shëron çdo lloj sëmundjeje dhe nxjerr shpirtrat e këqinj nga njerëzit. Njerëzit ngrihen në këmbë dhe e ndjekin atë nga pas. Ata vijnë edhe nga krahina të tjera, jashtë Jerusalemit, kryeqytetit të Izraelit. Gjithçka varet nga fjalët e tu...



Të varfrit janë të lumtur. Mbretëria e Zotit u përket atyre.

Të lumtur janë ata që kanë uri. Atyre do t'U permbushen të gjitha nevojat.




Të lumtur janë ata që qajnë. Ata do të qeshin përsëri.




Të lumtur jini ju, nëse njerëzit ju urrejnë dhe ju poshtërojnë kur më shërbeni mua, sepse i madh do të jetë shpërblime juaj në qiell.









Trajtojini njërezit ashtu si ju vetë do të donit që të tjerët t'Ju trajtojnë juve.




Ai që vështron një grua me ëndje, ka kryer në zemrën e tij tradhti bashkëshortore.




Mos u shqëtsoni për ditën e nësërme. Kërkoni së pari mbretërinë e Zotit dhe të tjerat vijnë vetë nga pas.




Duajini armiqtë tuaj dhe lutuni për ta.




Syri është ndriçimi i trupit. Është syri yt i pastër, je edhe t'I i ndriçuar. Por, është syri yt i turbullt, atëherë ti jeton në errësire.



Bëjeni të mirat në fshehtësi dhe jo që t'I marrin vesh të gjithë.



Asnjë njeri nuk mund t'I shërbejë dy zotërinjve njëkohësisht. Ose Zoti ose paraja.



Bëni atë që them unë. Kështu ju jeni si njeriu, që e ndërtoi shtëpinë e tij mbi shkëmb. Në qoftë se nuk vepron kështu, atëherë jeni si njeriu, që e ndërtoi shtëpinë e tij në rërë.



Një ditë, ndërsa njërezit po shtyhen për të hyrë në shtëpinë e Jezusit.

Ne nuk mund të hyjmë kurrë atje.



Atëherë e provojmë të hyjmë nëpërmjet çatisë.

Kjo është e bukur! E dëgjoni?



Ai po tallet me Zotin!

Vetëm Zoti mund t'i falë mëkatet!

Çfarë është më e lehtë t'i thuash një të paralizuari, të janë falur mëkatet, apo ngrihu në këmbë?



Çfarë po ndodh atje?



Lëri ata! Këta njerëz kanë shumë besim!

Djalë, ty të janë falur mëkatet!



Mesia ka fuqi të falë mëkatet. For unë them gjithashtu: Ngrihu, merr krevatin në krahë dhe ec!







E mrekullueshme!

Po! Unë eci përsëri!

Ai po ecën!

Por jo të gjithë janë të gëzuar me praninë e Jezusit. Udhëheqësit fetarë përgjojnë me vëmendje të madhe nëse ai u përmbahet rregullave, apo jo. Për shembull, në ditën e sabbatit (Të shtunën), është e ndaluar të punosh...



Këtu është një njeri, që njëren dorë e ka të tharë. A mund të bësh shërimë në këtë ditë, apo jo?



Shtrije dorën përpara!



Urra! Mua m'U shërua dora!



Në duhet t'I lajme hesapet me të!

Udhëheqësit në Jerusalem duhet ta dinë, që ai e shtien popullin në ngasje!



Kur gjallëria rritet, Jezusi tërhiqet, dhe lundron me nxënësit e tij përmes liqenin të Galilesë.





Mësues! Na ndihmo!  
Në po mbytemi!



Përse jeni kaq të frikësuar?  
Ku është besimi juaj?








Ata e nxjerrin barkën në një vend të qetë. Por në malet përreth...















Unë ju siguroj: Biri nuk mund të bëjë asgjë nga vetja e tij. Ai bën vetëm atë, që bën edhe ati. Unë nuk kërkoj të plotësoj dëshirën time, por dëshirën e atit, sepse ai me ka dërguar mua.

Rregullisht, Jezusi tërhiqet diku, për t'Ju lutur atit.




Pas një nate lutjesh ai zgjedh i2 dishepujt e tij. Ai u jep atyre fuqinë për të mposhtur shpirtrat djallëzorë dhe sëmundjet, dhe i dërgon dy e nga dy nëpër vende të ndryshme.




Këta janë dy vëllezërit, Pjetri dhe Andrea...



Dy vëllezërit Jakobi dhe Gjoni...



Filipi dhe Nataneli...





Tomasi dhe Mateusi (I cili më parë kishte punuar si tagrambledhës për pushtuesit Romakë)...



Tadeu dhe Jakobi tjetër...



Simon luftëtari dhe Juda iskarioti.



Shkoni tani. Kush ju pranon juve më pranon mua. Dhe kush më pranon mua, pranon atë, që më ka dërguar mua.



12 dishepujt kthehen entuziastë nga misioni i tyre. Pastaj ata së bashku, dëshirojnë të rrinë për pak kohë në qetësi. Por masa e njerëzve nuk i lë ata të qetë...

Të korrat janë të mbara, por punëtorët janë të paktë. Lutjuni Zotit, që të dërgojë punëtorë, për të mbledhur të korrat.





Ndërsa Jezusi vazhdon të flasë dhe të shërojë, bëhet vonë...

Filip, ku do ta gjejnë ushqimin gjithë këta njerëz? Sikur t'U jipnit ju atyre ushqim!



Ne kemi vetëm 200 monedha.  
Keto nuk mjaftojnë kurrë.

Këtu është një djalosh që ka 5 bukë dhe  
2 peshq. Më tepër ushqim nuk ka.

Ju kujdesuni që njërezit të ulen  
në grupe me nga 50.




Jezusi falenderon Zotin...

Më pas, ai vazhdon të ndajë  
bukët dhe peshqit.





Me mijra njerëz ushqehen me bukën, që ndau Jezusi...



Ne duhet ta bëjmë atë mbret!

Al është padyshim Mesia, që po të vinte.



Vështroni! Ka mbetur edhe për plot i2 muaj!



Tani në duhet t'I dërgojmë njerëzit në shtëpi, ju lundroni me barkë në anën tjetër. Unë do të qëndroj këtu në male, për t'U lutur.







Më vonë...



Mos u frikësoni. Jam unë!

Uaaaaaa! Një fantazem!



Zot, nëse me të vërtetë je ti, thuaje atëhere, që unë të eci nëpër ujë, për të ardhur tek ti.

Eja!



Zot më shpëto!



Pse dyshove, Pjetër?



Ka njerëz që duan, që Jezusi të bëhet mbret. Ata shpresojnë, që nën udhëheqjen e tij, pushtuesit Romakë të mund të shporren nga vendi. Por edhe numri i kundërshtarëve të Jezusit, po shtohet gjithnjë e më shumë. Ata gjithmonë kanë kritika dhe mendojnë, që ai nuk është i denjë. Ata duan t'I venë njerëzit kundra tij dhe kështu, të lajnë duart nga ai.



Mësues, kur keni ardhur këtu?

Më ndiqni ju mua për bukën që ju jap?



Mos u shqetësoni shumë për ushqimin që konsumohet, por për ushqimin që qëndron dhe jep një jetë të përjetshme.



Unë jam buka, që jep jetën e përjetshme. Mishi im është dhënë për jetën e kësaj bote.



Si mund të hamë në trupin e këtij njeriu?

Pallavra!



Largohuni njerëz!

Ejani! Ai e mashtron popullin!



A nuk doni edhe ju të shkoni me ta?

Zot, kë do të ndjekim në? Tek ti jetojnë fjalët e jetës së përjetshme!



Jezusi gjen gjithmone e më shumë kundërshtim. Ai largohet nga provinca e Galilesë. Me një grup njerëzish, që e ndjekin nga pas, burra e gra, vazhdon al punën e tij, në vende të tjera të Izraelit.

Galilea

Jerusalem

Izrael

Më vonë nisët ai për në Jerusalem.

Gjatë rrugës...

Për kë më mbajnë  
njërezit mua?

Ata thonë, së ti je  
një profet.

Po ju?

Për kë më  
mbani ju mua?

Ti je shpëtimtari, biri i  
Zotit që jeton.

Këtë mos ja thoni askujt. Mesia do të  
shkojë në Jerusalem, ku do të vuajë dhe  
do të vdesë. Por në ditën e tretë pas  
vdekjes, ai do të ngrihet nga varri.





Jashtë qytetit të Jerusalemit sheh shpesh njerëz të kryqëzuar, që vdesin nga ky ndëshkim i tmerrshëm Romak.



Al që do të vije pas meje, nuk duhet të mendojë më për veten e tij, por të marrë kryqin e tij në krahë dhe të më ndjekë mua.



Kush e shtrëngon fort jetën e tij, do ta humbasë atë, por kush e humbet jetën e tij për hir tim, do ta gjëjë atë përsëri.



Ju duhet ta dini mirë, që vetëm një zot egziston.



Kjo do të thotë, që ti ta duash Zotin tënd më gjithçka ke, dhe tjetrin ta duash si vetën tënde!



Në atë kohë në disa fshatra të Izraelit kishte njerëz, që ishin të sëmurë më lebër. Lebra është një sëmundje e keqe. Njerëzit që janë të prekur nga kjo sëmundje, nuk lejohen të vijnë në kontakt me njerëzit e shëndetshëm.



Nëse të sëmurët më lebër shkojnë diku, atëherë ata duhet të bërtasin me zë të lartë rrugës, që njerëzit të marrin vesh, që ata po kalojnë.

**Lebra! Lebra!**



Jezus! Mësues! Ki mëshirë për ne!







Shkoni tek prifti!




Tek prifti? Mos duhet të na vizitojë ai?

A shërohemi ne pastaj?



?

!



Po! Shërimi!



Ne u shëruam!

Ejani!



Haleluja! Zoti është i mirë! Faleminderit!



A nuk ishit ju dhjetë vetë, që u shëruat? Ku janë të tjerët atëherë, për të falenderuar Zotin?



Ngrihu! Besimi yt jo vetëm të shëroi por edhe të shpëtoi.



Udhëheqësit çifutë në Jerusalem dërgojnë pasuesit e tyre tek Jezusi, për ta përgjuar atë. Ata nuk i pëlqejnë ato që bën ai.

At shoqërohet me njerëz, që kanë një emër të keq, si femrat e këqia dhe tagrambledhësit, të cilët kanë lidhje me pushtuesit...



Mesia ka ardhur të gjejë dhe të shpëtojë atë, që ka humbur.


Sepse Jezusi shëron sëmundje ditën e sabbatit...

Shërohu!



Dhe ai u kushton një vëmendje të veçante fëmijëve...

Lëri fëmijët të vijnë tek unë, sepse për njerëz si ata, është mbretëria e Zotit.





Më pas, Jezusit i kërkohet të shkojë në Betanjë, një fshat pranë Jerusalemit. Llazari është sëmurë. Ai bashkë me motrat e tij, maria dhe Marta, janë shokë të mirë të Jezusit. Por, kur arrin në Betanjë, Jezusi dëgjon, që Llazari ka katër ditë që është varrosur...



Zot, po të kishe qenë ti këtu, vëllai im nuk do të kishte vdekur.



Vëllai yt do të ringjallet, Marta!



Po, këtë e di unë. Ai po të rikthehet në jetë në ditën e fundit, të ringjalljes.



Unë jam ringjallja dhe jeta. Kush beson tek unë do të jetojë. E beson këtë Marta?



Po o Zoti unë e besoj që ti je shpëtuesi i premtuar që do të vinte, biri i Zotit.




Ku e keni vendosur atë?

Hajde e shikoje, o zot!










Ata që kanë fuqinë në jërusalem, shqetësohen vazhdimisht për Jezusin dhe për mbështetjen, që gjen ai ngado.



Al njeri bën shumë mrekullira!

Në qoftë se në e lemë atë të vazhdojë kështu, atëherë Romakët, do të ndërmarrin ndonjë aksion.

Ata do të shkatërrojnë tempullin dhe popullin tonë!

Përdorni pak mëndjet tuaja!  
Është më mirë të vdesë një njeri për popullin, sesa të vdesim të gjithë!



Pra, Jezusi duhet të vdesë!



Që nga ky moment, udhëheqësit çifutë përpiqen të gjejnë një mundësi, për t'Ia dorëzuar Jezusin Romakëve. Vetëm ata mund të japin dënimin më vdekje.




Ndërkohë, në Betanjë po bëhet festë.



Ky parfum! Ky kushton aq shtrenjtë!

Maria!



Ne mund t'Ua kishim dhënë gjithë ato para të varfërve.



Lëre Juda! Ajo e ka ruajtur këtë ilaç, për varrimin tim.





Festa e pashkëve troket në derë. Grupe të mëdha njerëzish udhëtojnë për në Jerusalem.



Udhëheqësit çifutë thurrin në Jerusalem plane, për të arrestuar Jezusin. E megjithatë, ai shkon përmes qytetit.







Njërezit të gëzuar e përshëndesin atë...


Urra!

Urra!



Rroftë njeriu që vjen në emër. Të Zotit!

Mbreti i Izraelit!




Kështu nuk po na ecën mbarë.

E gjithë bota po shkon pas tij.



Tempulli në kryeqytet është qendra e besimit çifut.



Gjatë festimit të pashkëve njërezit therrin dele.



Më pas, një pjesë e çdo deleje ofrohet në tempull, për të lare mëkatet, që janë bërë kundra Zotit.



Por cila dele, mund të lajë me të vërtetë mëkatet e njerëzve?




Në sheshin e tempullit, bëhet një pazar i zhurmshëm dhe kthimi i parasë.



Papritmas, Jezusi gjendet në mes të sheshit...







Shtëpia e Zotit duhet të jetë një shtëpi lutjesh. Por ju e keni kthyer atë, në një han kusarësh!



Al është i rrezikshëm! Por njerëzit i shkojnë pas.



Ne patjetër duhet të gjejmë një mundësi për ta zhdukur atë!







Ditët e fundit para festës së pashkëve, Jezusi u predikon njerëzve në tempull, megjithëse udhëheqësit çifutë përpiqen ta bejnë këtë të dështojë. Më pas, Pjetri dhe Gjoni shkojnë të përgatisin darkën e pashkëve dhe qengjin.



Në mbrëmje, Jezusi së bashku me 12 dishepujt e tij vijnë në qytet, për të festuar darkën e pashkëve.



Sonte do të merret qengji i njerëzve.







Unë kam një dëshire të madhe, për të ngrënë së bashku me ju në këtë mbrëmje pashkësh, përpara së të fillojnë vuajtjet për mua.

Ata që kanë fuqinë në dorë, u japin urdhra e u venë rregulla atyre që kanë nën vetë, por tek ju ndodh e kundërta.

Ai që do të shërbejë me shumë, ai do të jetë edhe udhëheqësi juaj.




Unë jam mes jush një shërbëtor.









Bëjeni këtë vazhdimisht, që gjithmonë të më kujtoni mua...



Merreni këtë dukë. Kjo është pjesë e trupit tim.



Merreni këtë gotë. Këtu është gjaku im, që do të derdhet për ju. Që ketej, Zoti do të krijojë një lidhje të re me ju.



Unë po ju jap juve një urdhër të ri: Ta doni njëri tjetrin po aq, sa edhe unë ju dua juve.



Ne qoftë se kjo dashuri është mes jush, atëherë të gjithë do ta marrin vesh, që ju më ndiqni mua.



Zot, unë do të të ndjek ty ngado, dhe do të jap edhe jëten time për ty.



Pjetër, përpara së të këndojë gjeli, ti do të më mohosh mua tre herë.



Vonë, në mbrëmje, Jezusi dhe 11 dishepujt e tij dalin jashtë qytetit. Juda nuk është me ta...

Unë do t'Ju lë juve. Por ati do t'Ju dërgojë shpirtin e shenjtë. Ai do t'Ju ndihmojë dhe do të qëndrojë gjithmonë pranë jush.

Atje ku shkoj unë, atje është edhe rruga për ju.

Unë jam rruga dhe e vërteta e jetës. Asnjë njeri nuk mund të shkojë tek ati, përveçse nëpërmjet meje.

Ju qëndroni këtu. Unë do të shkoj më tutje për lutur.

O at, nëse është e mundur, m'I largo vuajtjet.

Por, le të bëhet jo ajo që dua unë, por ajo që do ti.



Si mund të flini ju tani? Ngrihuni!  
Vështroni, tradhtari im vjen!



Ju duhet të njeriun, të cilin do të uth unë!



Tungjatjeta mjeshtëri!



Juda, po e tradhton Mesian me një të puthur?

Zot, a të hidhemi ne në luftim?



Jo!



Kur Jezusi e le veten në duart e tradhtarëve, dishepujt e tij largohen fluturimthi, nga të katër anët.





Jezusin e sjellin tek kryepriifti. Ai është kryetari i udhëheqësve çifutë. Pjetri dhe Gjoni i ndjekin ata në një distance...



Pjetri futet brenda, në vendin ku e kanë sjellë Jezusin.



Hë, a nuk ishe edhe ti me të?



Unë as që e njoh atë, o njeri!

Por, ti je një prej dishepujve të tij...




Jo!

Unë e di të sigurt! edhe ti ishe atje! Ti je një Galileas!



Ti nuk di së çfarë po thua, o njeri!







Jezusin e sjellin përpara pilatit, kryetarit të legjioneve Romakë. Udhëheqësit çifutë përpiqen të ndezin gjakrat. Ata e fajësojnë Jezusin për lloj-Lloj gjërash.



Çfarë mendon ti për gjithë keto fajësime? Nuk thua ti asgjë?



Çfarë ke bërë ti?

Unë kam ardhur të dëshmoj për të vërtetën.




Cila është e vërteta?



Unë nuk shoh asnjë faj tek ky njeri. Tani ne kemi festë, kë do të lirojmë: Barabën, apo këtë mbret të çifuteve?











Vështroji njerëzit!

Kryqëzoje atë!

Kryqëzoje atë!

Kryqëzoje atë!





Pilati nënshkruan ndëshkimin. Kryqëzimi është një ndëshkim i tmerrshëm me vdekje. Jezusi mban kryqin e tij në krahë, tek ecën rrugëve të Jerusalemit.





Jashtë qytetit shtrihet vendi, ku do të kryhet dënimi. Ky vend quhet gollgota (Kafka).



Atje ushtarët e gozhdojnë Jezusin në kryq.











Pilati urdhëroi që mbi kryq të shkruhet një mbishkrim. Në tre gjuhë të ndryshme, është shkruar: "Jezusi, mbreti i çifutëve."

Jezusi nuk pranon të pijë një ilaç, që është për të larguar vuajtjet.

Ushtarët hedhin short, së kush do marrë rrobat e tij.



Po! Ai ka shpëtuar edhe të tjerë, apo jo?

Është ai biri i Zotit? atëherë le t'I shpëtoj kryqëzimit!

Ki nder për Zotin, në po marrim atë që meritojmë, por ai nuk ka bërë asgjë për ta merituar këtë.

Shpëto veten tënde edhe në bashkë me ty!



Mendo për mua, kur të shkosh në mbretërinë tënde!

Unë do të siguroj: Sot ti do të vish me mua, në parajsë.



Rreth orës dymbëdhjetë gjithçka  
nxihet, prej një errësimi të  
pakuptueshëm të diellit.

Maria, nëna e Jezusit dhe e  
Gjonit dhe dishepujt e tij,  
qëndrojnë pranë kryqit.

Ju jeni tani  
mëmë e bij.

O Zoti im, o Zoti im, përse u  
largove prej meje?


Unë...Etje!

O at, në duart e tua, do jap  
shpirtin tim.

U...Krye!



Jezusi vdes në oren tre, në drekë.  
Ushtarët e godasin më heshtë në ije,  
prej nga del ujë dhe gjak.



Në libra është shkruar: Atë e  
sollën si një qengj, në sofrën  
e ndëshkimit.



Ai mori ndëshkimin e  
mëkateve tona. Por  
tani ai ka vdekur.




A ishte ai Mesia, që  
do të vinte, apo jo?



Hajde të pyesim nëse në  
mund ta varrosim atë.



Jozefi nga arimatea dhe nikodemi, e marrin  
trupin e Jezusit më vete. Ata e balsamojnë  
trupin, e lidhin me pëlhurë. Dhe e vendosin në  
një varr në shkëmb, të cilin e mbyllin mirë, më  
një gur të madh shkëmbi.






Pas një periudhe pushimi, që bëhet pas festimit të pashkëve, disa gra shkojnë tek varri i vulosur...




Guri është larguar nga varri!



Përse e kërkonti të gjallin ndërmjet të vdekurve? Ai është ringjallur. Shkoni e tregojani këtë dishepujve!



Kur Pjetri dhe Gjoni e dëgjojnë këtë, ata vrapojnë tek varri.




Çfarë ka ndodhur?




E gjitha bosh!








Jashtë, në kopshtin  
përpara varrit...



Grua, përse po qan?  
Kë kërkon ti?




E keni larguar ju  
atë, zotëri?



Marie!



Mësues!




Mos më mbaj. Tregoju  
vëllezërve të mij, që  
unë po kthehem tek ati  
im e ati juaj, tek Zoti  
im e Zoti juaj.



Po në të njëjtën ditë, dy pasues të diziluzionuar të Jezusit, takojnë një udhëtar dhe bisedojnë me të mbi ekzekutimin e Jezusit...

A nuk i besoni ju ato, që thonë profetët? a nuk duhej të vuante Mesia, për të ngritur lavdinë e tij? Të gjitha këto janë të shkruara në librat e profetëve!



Gjate kohës së ngrënies, miku i tyre zhduket menjëhere...

Por, al ishte vetë Jezusi!



Ata menjëherë shkojnë të kërkojnë dishepujt e tjerë.

Ne kemi parë Mesian!



Maria dhe Pjetri gjithashtu!

Papritmas...

Unë ju uroj paqe!



Nuk e besoni që jam unë? Vështroni duart dhe këmbët e mia!





Zoti dhe perëndia im!






Dyzet ditë me radhë u del Jezusi përpara pasuesve të tij. Ai u paraqitet, edhe 500 njerëzve në të njëjtën kohë. Një ditë, disa nga dishepujt, kanë dalë për peshkim...






Pjeter, a më do me të vërtetë mua?



Jezusi ia bën tre herë me radhë këtë pyetje Pjetrit..



Po, o zot, ti e di, që unë të dua.

Kujdesu atëherë për delet e mia!



Më ndiqni mua!

Mua më është dhënë gjithë fuqia, në qiell dhe mbi tokë. Shkoni nëpër botë, bëjini të gjithë popujt, dishepuj të mij. Pagëzojini ata, në emër të atit e birit e shpirtit të shenjtë. Mësojini ata të bëjnë ato, që unë ju kam mësuar juve.



Mbani mend mirë këtë, që po u them: Unë jam gjithmonë me ju, ditë e natë, deri në fund të botës.



Pasi thotë keto fjalë, Jezusi largohet nga bota. Ai merret në qiell. Por ai tha gjithashtu, që ai do të kthehet përsëri, për të gjykuar njerëzit...




Jezusi është larguar. Pasuesit e tu presin, duke u lutur, në Jerusalem. Atëherë shpirti i shenjtë vjen tek. Ta. Shpirti i Zotit, që ishte te Jezusi, është tani edhe tek pasuesit e tij. Kjo i bën ata njerëz të rinj. Të cilët dëshmojnë fuqishëm për Jezusin.

Vdekja nuk mundi ta mbante Jezusin në gjirin e saj. Zoti e ringjalli atë përsëri. Jezusi është i pari, që shkoi në mbretërinë e mrekullueshme të Zotit.



Pasuesit e Jezusit kanë ngado shumë kundërshtim.

Jezusi është biri i Zotit.




Al mori mëkatet tona mbi trupin e tij kur vdiq në kryq. Mëkatet tona u paguan me gjakun e tij. Ne mund të jetojmë ashtu si dëshiron Zoti.

Ngado në botë ka tani njerëz që ndjekin Jezusin. Ata luten dhe lexojnë rregullisht biblën. Ata ndajnë bukën dhe e çojnë gotën e verës dorë më dorë, si kujtim të vdekjes së Jezusit. Ata shpërndajnë dashurinë e Zotit, që jeton në zemrat e tyre.





Jezusi u kujdes, që ajo që kishte në plan Zoti me njerëzit, të bëhet e mundur.



Jezusi të do ty. Falenderoje dhe nderoje atë!



Por, perëndia (Zoti) aq shumë e deshi botën, saqë e dha birin e tij të vetëm, që të mos mbarojë kushdo që beson në të, por ta ketë jetën e përjetshme.



## BIBLA

Historia e Jezusit është e shkruar në Bibël. Asnjë libër tjetër nuk ka qenë lexuar ndonjë herë dhe nuk lexohet aq shumë sa Bibla. Ky është një libër plot me libra më të vegjël. Zgjati afërisht 1500 vite për tri shkruar këto libra. Rreth 1900 vite më parë Bibla ishte mbaruar së shkruari. Në Bibël janë të shkruara shumë historira për mirësinë e Zotit ndaj njerëzve. Historia për Jezusin tregon më mirë se kush është Zoti.


## HISTORIA E JEZUSIT

Në Bibël janë të shkruara 4 libra të cilët përshkruajnë jetën e Jezusit. Këto libra janë emëruar sipas shkrimtarëve të tyre. Ata të gjithë kanë jetuar në të njëjtën kohë si edhe Jezusi.

1. Mateu - një nxënës i Jezusit. Ai punonte tek shërbimi i tatimeve. Ai përshkruan kryesisht se si shkonte Jezusi me banorët e Izraelit (hebrenjtë).

2. Marku - ishte ende i ri kur Jezusi kryente punën e Tij. Ai shkruan shumë për mrekullitë që kryente Jezusi.

3. Luka - ishte me profesion mjek. Ai nuk e njihnte Jezusin personalisht. Luka shkruan mbi mënyrën se si shkonte Jezusi me njerëzit.



4. Gjoni edhe ky ishte një nxënës i Jezusit. Ai tregon sidomos se hish ishte Jezusi. Jezusi është Zoti që u bë njeri për t'i shpëtuar njerëzit nga mëkatet e tyre.




## LINDJA E JEZUSIT

Nëna e Jezusit ishte Maria. Kur lindi Jezusi, Maria ende nuk ishte martuar. Ajo ishte ende virgjëreshë. Por Zoti u kujdes që Jezusi të mund të lindej. Kjo mrekulli ishte shpallur shumë kohë më parë në librat që ishin shkruar shumë më parë kohës së Jezusit. Jezusi nuk lindi si ndonjë hero ose si ndonjë rast i vecantë. Ai lindi në një stan, sepse asgjëkundi tjetër nuk kishte vend për të bërë lindjen e fëmijës.


## MREKULLITE E JEZUSIT

Jezusi kreu shumë mrekulli. Në Bibël për shembull janë përsh-kruar më shumë se 40 shërime. Me këto mrekulli që kryente, Jezusi tregonte që Zoti është fuqishëm. Dhe që Ai do t'i ndihmojë njerëzit dhe do t'i bëjë ata të lumtur.





## VDEKJA DHE RINGJALLJA E JEZUSIT



Përse vdiq Jezusi? Kjo shpjegohet në Bibël.

Shiko, të gjithë njerëzit bëjnë nganjëherë gjëra të gabuara. Gjëra që Zoti nuk i do dhe të cilat e mërzhisin shumë Atë. Këto gjëra quhen mëkat. Për shkak të gjithë këtyre mëkateve, njerëzit nuk mund të jenë miq të Zotit.

Për këtë arsye erdhi Jezusi mbi tokë. Ai vullnetarisht mori mbi Vete ndëshkimin e mëkateve tona. Ky ndëshkim ishte vdekja. Meqënëse Jezusi vdiq në vendin tonë, ne mund të pajtohmi me Zotin. Ne duhet të kemi pendim për gjërat e këqija që ne kemi bërë.

Jezusi edhe u ringjall nga vdekja. Zoti e ringjalli Atë. Me këtë Zot tregoi që Ai është më i fortë se vdekja.

Tani Jezusi jeton pranë Zotit. Dhe meqënëse Ai jeton, Ai mund të jetë shoku ynë përgjithmonë. Ai do të na ndihmojë ne të jetojmë në mënyrë të tillë që Zoti të jetë i kënaqur me ne.

### Lutje

*A dëshiron ti të bëhesh një mik i Zotit? A ke pendim ti për gjithë ato gjëra që ke bërë gabim? Atëherë thuaje këtë lutje:*

*"Zot i dashur, Ju më doni mua.*

*Ju dhatë Jezusin, Birin Tuaj.*

*Ai vdiq në kryq për hir të të gjitha gjërave të gabuara që kam bërë unë.*

*A doni të me falni për ato gjëra që unë bëj gabim? Unë jam penduar.*

*Ju faleminderit që Jezusi më mbron mua.*

*Unë dua t'ju përkas juve.*

*A doni të më ndihmoni që unë të jetoj ashtu si dëshironi ju?*

*A do të qëndroni gjithmonë pranë meje?*

*Ju faleminderit që Ju i përgjigjeni lutjes sime.*

*Ju e bëni atë që premtomi!"*



## JEZUSI DHE TI

Historia e Jezusit nuk ka mbaruar ende. Jezusi u bë një shok dhe mik për shumë e shumë njerëz. Jo vetëm atëherë, por edhe tani. Bota ka ndryshuar. Ne nuk udhëtojmë më me gomerë dhe kuaj, por me makina dhe me aeroplanë. Por për Jezusin kjo nuk ka rëndësi. Ai mund të jetë po aq pranë teje sa edhe kur Ai ishte në Izrael me njerëzit atje.

Ai është i padukshëm tani, por është po aq i vërtetë sa edhe atëherë. Edhe tani Ai dëshiron të jetë një shok të cilin ta dëgjosh dhe ta duash.

A do të dish më shumë mbi Jezusin dhe se si mund të jetosh me Të? Nëse po, mund të veprosch si më poshtë.

1. Lexoje Biblën vetë (fillo për shembull me librin e Lukës).

2. Fillo të lutesh (të flasësh me Zotin dhe ta dëgjosh Atë).

3. Foi me njerëz të tjerë për Jezusin dhe Biblën. Jezusi do që nxënësit e Tij të gjejnë njëri-tjetrin dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin të mësojnë më shumë nga Ai.

*Text and illustrations: Willem de Vink.*


*Copyright © 1993 Stichting Wereldtaal, Houten, The Netherlands. Published in Dutch as "Jezus Messias".*

*Edition in Albanian © 1994,2018*


*Digital copyright under the terms of the Creative Commons BY-SA license*

*All rights of translation, reproduction and adaptation reserved for all countries.*

*email: jmpbk.app@gmail.com*







*Kjo është historia e ndodhur në të vërtetë e Jezus Mesias. Ai jetonte në Izrael, rreth 2000 vite më parë. Kushdo që e ka shikuar, dëgjuar apo takuar Atë është habitur. Asnjëri më parë nuk kishte bërë atë që bëri Ai. Asnjëri nuk kishte thënë më parë atë që tha Ai. Kudo ku vinte Ai ndodhnin mrekulli. Dhe këdo që donte të dëgjonte fjalët e Tij, Ai e bënte të lumtur dhe të gëzuar. Megjithëkëtë, papritmas mbaroi. Kundërshtarët e Tij e dërguan Atë drejt vdekjes. Por ky nuk ishte fundi. Lexoje vetë se si ndodhi e gjithë kjo histori dhe se si shkoi puna e Jezus Mesias.*

*language: Albanian*

*ISBN:*